

Rekomandime të politikave për përfaqësuesit serbë në institucionet qendrore të Kosovës

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive ka organizuar më 20-21 dhe 25 shtator të vitit 2014, dy aktivitete për një numër përfaqësuesish serbë: një punëtori në Aranxhelovac dhe një tryezë të rumbullakët në Beograd. Aktivitetet kanë qenë pjesë e projektit të mbështetur nga Departamenti Federal Zvcirran i Punëve të Jashtme.

Pjesëmarrësit në punëtori kanë draftuar një listë të sugjerimeve dhe rekomandimeve për përfaqësuesit serbë në institucionet e Kosovës. Porosia e përgjithshme e rekomandimeve të punëtorisë ka qenë se përfaqësuesit serbë duhet të veprojnë më shumë si një forcë politike se sa si parti etnike, dhe së këndejmi të angazhohen më shumë në çështje joetnike, përfshirë këtu buxhetin e Kosovës, privatizimin, projektet infrastrukturore siç janë autostradat dhe bujqësia. Ata poashtu duhet ti kanalizojnë përpjekjet dhe idetë e tyre përmes institucioneve. Një tjetër rekomandim ka qenë që ata duhet gjithashtu të ndihmojnë në ndërtimin e institucioneve efikase në komunat me shumicë serbe, si garanca më e mirë për një të ardhme të qëndrueshme për komunitetin serb.

Tryeza e rumbullakët në Beograd ka rishikuar, diskutuar dhe ka kontribuar në rekomandime dhe është pajtuar që ti mbështesë ato. Porosia e tryezës së rumbullakët ka qenë që serbët duhet të jenë pjesëmarrës më aktiv në jetën politike të Kosovës. Pjesëmarrësit presin që stabilizimi i gjendjes në veri të mbetet një sfidë në të ardhmen e afërt, por kanë mbështetur zbatimin e marrëveshjes së Brukselit, edhe pse disa kanë pasur rezerva sa i përket marrëveshjes dhe procesit të dialogut.

Sfida kryesore në të ardhmen e afërt do të jetë krijimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Një ekip përfaqësuesish serbë janë duke punuar në statutin e Asociacionit dhe shumica presin që kjo të jetë një çështje e ndijshme në momentin kur fillojnë diskutimet mes serbëve dhe Prishtinës në lidhje me Asociacionin, ku të dyja palët mbajnë qëndrime mjaft të fortifikuara. Serbët presin që ky të jetë një lloj institucioni, kurse Prishtina thotë se asociacioni duhet të ketë statusin e një organizate joqeveritare. Sugjerimi që i është bërë ekipit që është duke punuar në statut ka qenë që statuti duhet të jetë sa më realist.

Disa kanë thënë se komunikimi dhe bashkëpunimi me komunitetin shqiptar duhet të ngritet dhe të shihet se ku takohen pritjet e serbëve me ato të shqiptarëve.

Statusi i Universitetit të Mitrovicës ka tërhequr mjaft vëmendje. Pjesëmarrësit kanë sugjeruar që të punohet në drejtim të “profesionalizimit dhe legalizimit të tij”. Një universitet i mirë për serbët në Kosovë, do të luante një rol kyç, pasi që “një komunitet pa intelektualë nuk mund të përparojë”, ka thënë një folës. Kujdesi shëndetësor ka qenë një fushë tjetër e cila konsiderohet shumë e rëndësishme për komunitetin. Tani për tani, klinikat që udhëhiqen nga serbët lejohen të operojnë në Kosovë, por konsiderohen ilegale nga institucionet e Kosovës.

Rekomandimet

Udhëzimet e përgjithshme për veprim.

Është në interesin e komunitetit serb që përfaqësuesit e tyre të bëjnë një politikë autentike në parlament dhe në nivelet tjera të pushtetit, me qëllim të avancimit të interesave nacionale dhe përmirësimit të jetës së serbëve në Kosovë.

1. Rol aktiv në formimin e qeverisë.

- 1) Definimi i qëllimeve strategjike për t'iu bashkuar koalicionit qeverisës.
- 2) Përfaqësimi transparent i interesave të komunitetit serb në Kosovë gjatë negociatave për formimin e qeverisë.
- 3) Përfaqësuesit serbë në parlamentin e Kosovës, përveç temave të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me komunitetin serb, duhet poashtu të merren me çështje tjera të rëndësisë publike.

2. Zgjedhja e përfaqësuesve serbë të komunitetit serb në të gjitha nivelet e qeverisë është thelbësore.

- 1) Përfaqësuesit me përvojë politike, autoritet, reputacion dhe kredibilitet duhet të nominohen dhe të zgjedhen si anëtarë të qeverisë.
- 2) Për funksionet tjera në të gjitha nivelet e qeverisë, njerëzit më të kualifikuar, me një nivel të duhur të dijeve dhe të familjarizuar me çështjet dhe problemet duhet të nominohen dhe të zgjedhen.
- 3) Duhet të punësohen më shumë ekspertë në nivelin qendror dhe lokal, për të përkrahur punën e përfaqësuesve serbë. Kurdo që është e mundur, duhet të punësohen serbët e Kosovës për këto pozita.
- 4) Të promovohen principet e barazisë gjinore dhe përfaqësimit rajonal në zgjedhjen e përfaqësuesve.
- 5) Ndërtimi i marrëdhënieve më të mira me shumicën dhe komunitetet tjera, me qëllim të stabilizimit të gjendjes dhe përmirësimit të bashkëjetesës në Kosovë.

3. Vazhdimi i dialogut dhe zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit. Krijimi i Asociacionit/Komunitetit të Komunave me Shumicë Serbe.

- 1) Krijimi i Asociacionit/Komunitetit të Komunave me Shumicë Serbe. Definimi i përgjegjësive të tij dhe mënyrat e financimit.
 - (a) Iniciativat në parlamentin e Kosovës, qeverinë dhe institucionet tjera, me qëllim të dhënies së autoritetit Asociacionit/Komuniteteve të komunave serbe, në mënyrë që i njëjti të përfaqësojë në mënyrë të drejtë interesat e serbëve të Kosovës.
 - (b) Bashkëpunimi me elitën politike të shqiptarëve të Kosovës në arritjen e kapacitetit të plotë të Asociacionit/Komunitetit të komunave serbe.
 - (c) Bashkëpunimi me institucionet e Republikës së Serbisë në procesin e formimit të Asociacionit/Komunitetit të komunave serbe.
 - (d) Përfshirja e përfaqësuesve serbë në sigurimin e financimit stabil të Asociacionit/Komunitetit të komunave serbe.
- 2) Vazhdimi i dialogut të Brukselit.
 - (a) Përfaqësuesit serbë në parlament, qeveri dhe në institucione tjera në Kosovë, duhet që në mënyrë aktive të promovojnë procesin e pajtimit dhe bashkëjetesës, si dhe të përdorin ndikimin e tyre në definimin e temave në dialogun e Brukselit.
 - (b) Zgjidhja e problemeve në sistemin e edukimit dhe shëndetësisë është prioritet (njohja e diplomave të Universitetit të Mitrovicës, furnizimi me medikamente dhe pajisje mjekësore etj).
 - (c) Sigurimi i plotë i lirisë së lëvizjes (targat, pagesa e sigurimit në pikëkalimet administrative, dokumentet personale etj.)
 - (d) Zgjidhja e çështjeve kontestuese rreth pronave dhe privatizimit.
- 3) Zbatimi i të gjitha marrëveshjeve të arritura deri tani.

4. Të drejtat e njeriut.

- 1) Mbrojtja e pronave private të serbëve (kthimi i pronave të uzurpuara)
 - (a) Inicimi i formimit të grupeve punuese të cilat do të shqyrtonin raste të kontestuara të uzurpimit dhe shpërdorimit të aseteve.
 - (b) Inicimi i amandamenteve të ligjeve dhe rregulloreve të cilat do ta shpejtonin procesin e kthimit të pronave.
- 2) Garantimi i të drejtës për punë dhe kthim në vendet e tyre të punës. Punësimi i serbëve në kompanitë publike.
 - (a) Avokimi për zbatimin konsistent të Ligjit për Shërbimet Publike, i cili garanton që pjesëtarët e komuniteteve joshumicë të përbëjnë së paku 10 përqind të fuqisë punëtore.
 - (b) Rishikimi i pagesave bërë punëtorëve në bazë të privatizimit i cili është bërë gjatë periudhës së lirisë së kufizuar të lëvizjes të personave të zhvendosur brenda Kosovës, dhe gjatë kohës kur ka pasur mungesë të qasjes në Agjencinë e Privatizimit dhe në autoritetet gjyqësore.
- 3) Insistimi në zbatimin konsistent të Ligjit për Gjuhët.
 - (a) Përfaqësuesit serbë në qeveri dhe parlament, në bashkëpunim me komisionerin për gjuhët në zyrën e kryeministrit, duhet të insistojnë në zbatimin konsistent të Ligjit për Gjuhët.
- 4) E drejta e të zhvendosurve për tu kthyer.
 - (a) Avokimi për të siguruar kërkesat e nevojshme me institucionet relevante për kthimin e personave të zhvendosur dhe integrimin e tyre.
 - (b) Krijimin e bashkëpunimit të plotë mes Ministrisë për Kthim dhe Komunitet të Kosovës dhe Komisarariatit për Refugjatë të Serbisë.
- 5) Mbrojtja e statusit dhe pronës së Kishës Ortodokse Serbe, dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore e historike.
 - (a) Të insistohet në implementimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, fshatin e Hoçës së Madhe, liritë fetare dhe zonat e mbrojtura.
 - (b) Të insistohet në vazhdimin e renovimit të objekteve fetare të Kishës Ortodokse Serbe.
- 6) Të garantohet barazi e plotë dhe qasje për të gjithë në autoritetet gjyqësore dhe institucionet publike.
- 7) Formimi i institucioneve të besueshme dhe legale në komunat me shumicë serbe të cilat përmbushin nevojat e popullatës lokale në linjë me Marrëveshjen e Brukselit dhe Planin e Ahtisaarit.
- 8) Garantimi i qasjes më të mirë në arsim dhe shëndetësi për serbët të cilët jetojnë jashtë komunave me shumicë serbe, si dhe garantimi i përfaqësimit të tyre në Asociacionin/Komunitetin e Komunave me Shumicë Serbe.
- 9) Përmirësimi i sigurisë për serbët të cilët jetojnë jashtë hapësirave me shumicë serbe.

5. Zhvillimi ekonomik.

- 1) Pjesëmarrja aktive në krijimin e një kilme më të favorshme për investime në Kosovë.
 - (a) Lufta kundër krimit dhe korrupsionit.
 - (b) Pjesëmarrje e plotë e përfaqësuesve të autoriteteve lokale në procesin e privatizimit, dhe angazhimi i përfaqësuesve të komunitetit serb në parlament në iniciimin e diskutimeve me qëllim shqyrtimin e procesit.
 - (c) Krijimi dhe fuqizimi i infrastrukturës së biznesit me qëllim të ngritjes së nivelit të konkurrencës.
 - (d) Ulja e tatimeve dhe ngarkesave të cilat dobësojnë konkurrencën, si dhe garantimi i zbatimit më efikas të marrëveshjes së CEFTA-s.
 - (e) Largimi i pengesave tregtare, sic janë monopolët dhe kartelet që kanë monopolizuar importet.
- 2) Mundësimi i riregjistrimit të entiteve biznesore që janë të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në të Serbisë, në Regjistrin Komercial të Kosovës, përmes një procedure të lehtësuar.
- 3) Anulimi i dispozitave të caktuara të Ligjit të Punës dhe Ligjit të Prokurimit Publik për një periudhë të kufizuar, për të lejuar që kompanitë e komunitetit serb të përfshihen në sistemin ekonomik të Kosovës.

- 4) Krijimi i pakos së masave fiskale me qëllim të ringjalljes së ekonomisë dhe ndërmarrësisë në hapësirat serbe.
- (a) Ofrimi i incentivave.
 - (b) Propozimi i adoptimit të incentivave fiskale.
 - (c) Pjesëmarrja aktive në monitorimin e shpërndarjes së fondeve të Fondit të Zhvillimit për veriun.
 - (d) Alokimi i më shumë fondeve nga buxheti me qëllim të zhvillimit ekonomik të komuniteteve serbe

**LISTA E PJESËMARRËSVE
NË AKTIVITETET E CIG TË ORGANIZUARA NË MUAJIN SHTATOR 2014
NË ARANDJELOVAC DHE BEOGRAD, SERBI**

Zdravka Erak, Këshilltare e lartë, Komiteti për Kosovë e Metohi, Parlamenti i Serbisë
Marko Jaksic, Analist, Mitrovicë Veri
Vesna Jovanovic, Drejtori për Arsim, Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Rini dhe Sport, Komuna e Parteshit
Vladeta Kostic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progressive Serbe
Milivoje Mihajlovic, Drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Media, Qeveria e Serbisë
Ljubisa Mijacic, Analist, Zubin Potok
Petar Miletic, Ish-zëvendës Kryetar i Parlamentit të Kosovës
Smiljka Milisavljevic, Profesor, Universiteti në Mitrovicë
Dragan Nikolic, Kryetari i komunës së Parteshit
Srdan Popović, Drejtor, Zyra për Komunitete të Kryeministrit të Kosovës
Dejan Radenkovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Nenad Radosavljevic, Drejtor i Bordit, Rrjeti i Pavarrur i TV Stacioneve Serbe në Kosovë
Vinka Radosavljevic, Kryesues i Rajonit të Pejës të Qeverisë së Serbisë
Branko Ruzic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Predrag Simic, Profesor, Universiteti i Beogradit
Aleksandra Sanjevic, Koordinator i Programit, Fondacioni për Shoqëri të Hapur
Rada Trajkovic, Ish-anëtare e Parlamentit të Kosovës
Janko Veselinovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia e Re Demokratike
Stevan Vulovic, Kryetar i Komunës së Zubin Potokut
Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Alex Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Igor Novakovic, Bashkëpunëtor në Serbi, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Julien Stauffer, Atashe, Ambasada e Zvicrës në Serbi